

■ **GJURMËVE TË TREGËTISË ILEGALE ME ORGANE NJERËZORE NË MAQEDONI (3)**

# TRANSPLANTI I GJAKUT DHE ZEMRËS

Në Maqedoni operon një rrjet i tregëtarëve të organeve, i cili përbëhet nga mjekë-kirurgë dhe kontrabandistë, të cilët kanë për detyrë të gjejnë dhe përgatisin "dhurues" të organeve dhe t'i dërgojnë në Shqipëri ose Greqi, ku janë të vendosura klinikat për transplantim të organeve

## XHELAL NEZIRI

Ai thotë se është munduar t'i bindë bashkëkombasit e tij që mos të shesin organet, por më kot.

"Pasi ia bënin analizat, atë e merrnin dhe e dërgonin ilegalisht në Shqipëri. Më pas e kthenin në këtë vend me para në duar. Pasi që bënin para e lërnin këtë vend dhe shkonin për të jetuar në Shkup, në ndonjë shtëpi me tulla", rrëfen Ilmiu.

Sipas tij, në një rast kanë sjellur një "donator" të vdekur.

"E morën për t'i marrë vetëm veshkën por e sollën të vdekur. Na e lanë këtu dhe ikën. Nuk e di nëse i kanë marrë të gjitha organet", thotë Ilmiu.

Ai pohon se edhe vetë është viktimë e tregëtisë me organe, por pa dëshirën e tij.

"Shoqja ime ka problem me veshkët. Shpesh duhet të shkojë në spital. Para dy viteve e dërgova në Shkup për ta kontrolluar dhe shëndoshur. Më thanë se nuk i punojnë mirë veshkët dhe më propozuan që njëri veshkë t'ja jepja unë. U pajtova dhe shkuam në sallën e operacionit ku menduam se është bërë transplant. Mirëpo, gruaja ime prapë vazhdoi me probleme të veshkëve. Kur shkova te një specialist në Tetovë

më tha se veshka ime as që është transplatuar te gruaja ime. Këtu doktorët jo vetëm paratë por edhe organeti t'i vjedhin", thotë Ilmiu.

## Policia "s'ka" të dhëna

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në Maqedoni thotë se s'ka të dhëna se në këtë vend po lulëzon tregëtia me organe njerëzore.

"Ne si Ministri nuk kemi rregjistruar ndonjë akt kriminel të kësaj natyre. Në momentin kur do të hetojmë një veprimtar të fillit ilegal ne gjithsesi se do të veprojmë në mënyrën më energjike", tha zëdhënësi i i MPB-së, Ivo Kotevski.

Ai nuk dëshiroi të komentojë rastin e Beqirovit dhe rastet tjera të romëve viktimë të tregëtisë ilegale me organe njerëzore.

"Në Ministrinë e Shëndetësisë është formuar një Trup koordinues për këtë problematik. Ata kanë bërë inspekcione dhe i kanë detajet", shtoi ai.

Në Trupin koordinues thanë se inspekcionet e Ministrisë së Shëndetësisë nuk kanë rregjistruar asnjë rast të transplantimit ilegal të organeve.

Ky trup u formua pas raportit të fundit të Organizatës Shëndetësore Amerikane, ku Maqedonia përmendej në grupin e shteteve ku është prezente tregëtia ilegale me organe. Sipas kësaj



• ORHANI, SHOKU I TRAJANIT, ME TE CILIN KISHTE QENE BASHKE NATEN FATALE •

organizate, Maqedonia është vend ku të pasurit bëjnë të ashtuquajturin "turizëm të transplantimit", ku ofrohen veshkë, mushkëri të zeza, membranë e zemrës dhe lëkurë.

Edhe Bashkësia Evropiane për transplantimin e organeve, në raportin e saj, ka vënë Maqedoninë në listën e vendeve donator të organeve.

## Rrjeti i tregëtarëve

Nga ana tjetër, burime në Ministrinë e Shëndetësisë, thonë se në Maqedoni

operon një rrjet i tregëtarëve të organeve, i cili përbëhet nga mjekë-kirurgë dhe kontrabandistë, të cilët kanë për detyrë të gjejnë dhe përgatisin "dhurues" të organeve dhe t'i dërgojnë në Shqipëri ose Greqi, ku janë të vendosura klinikat për transplantim të organeve.

"Tërë rrjeti në Ballkan dhe më gjerë në Evropë kontrollohet nga ekspertë Izraelitë, të cilët edhe kanë hapur klinikat në Shqipëri dhe Greqi. Ata, në mënyra të ndryshme, imponohen te

pacientët e vendeve të zhvilluara si shpëtim për ta apo për të afërmit e tyre. Këto njerëz u ofrojnë donator organesh nga India e Pakistani por edhe nga vendet e Ballkanit", thonë burimet.

Sipas tyre, në vitin 2001 dhe 2002 nga biznesmenë dhe kirurgë izraelitë ka pasur iniciativë për ndërtimin e një klinike për transplantim të organeve, me qëllim që donatorët nga Maqedonia të mos kalohen ilegalisht në klinikat në Shqipëri dhe Greqi.

"Ata ishin thelisht të interesuar të investojnë në këtë klinikë për bartjen ilegale të organeve. Dy të parat i kishin hapur në vitin 1994 në dy vende fqinje. Ishin të interesuar të ndërtojnë klinikë supermoderne edhe këtu, por nuk e di pse s'u kthyen më", theksojnë burimet.

Sipas tyre, përveç transplantimit të organeve ky rrjet bën edhe kontrabandimin e fëmijëve romë dhe bonjakë nga Maqedonia drejt Italisë dhe Greqisë. Atje, në të shumtën e rasteve, shfrytëzohen si dhurues organesh, me ç'rast përveç veshkëve ka raste kur u merret edhe gjaku apo zemra.

"Një fëmijë të gjinisë mashkullore e shesin për afër 50 mijë euro derisa vetëm mushkërinë e zezë të fëmijës për 30 mijë euro. Për veshkë më tepër kërkojnë nga 20 deri më 30 mijë euro", thonë burimet. (Fund)

*(Kjo storje hulumtuese është realizuar me mbështetjen e SCOOP-it dhe Shoqatës Daneze të Gazetarëve Hulmues)*



## KRIMINALITETI NË VERI TË KOSOVËS

### Policë të përfshirë në kontrabandë

RTK ka siguruar raportin e inspektimit të jashtëzakonshëm për Komandën rajonale të Mitrovicës, lidhur me përfshirjen e mundshme të zyrtarëve policorë në kontrabandimin e mallrave në këtë pjesë të vendit. Mungesa e komunikimit mes stacionit policor të veriut dhe atij të jugut, kontrolli i dobët i vijës kufitare, mbikëqyrja jo e duhur e policëve që punojnë në pikat e nxehta, ku dyshohet të zhvillohet kontrabanda, sipas raportit duket se janë faktorët kryesor që mundësojnë zhvillimin e

kontrabandës në veri. Janë gjithsej 4 faqe të raportit të IPK-së që flasin për implikimin e mundshëm të zyrtarëve policor të Mitrovicës. Megjithatë IPK ka arritur të identifikojë 2 policë të Mitrovicës, të cilët dyshohet se janë të implikuar në Kontrabandë. Ministri i Brendshëm Zëno Pajaziti beson se me realizimin e rekomandimeve që dalin nga raporti i IPK se do të mundësohet një kontroll më i mirë i veriut dhe gjithsesi zvogëlim i rasteve të kontrabandës së çfarëdo natyre në këtë pjesë të vendit.

## AMBASADORI GJERMAN NË PRESHEVË E BUJANOC

### Serbia jugore është një rajon i veçantë

Përfaqësuesit institucional të shqiptarëve të Luginës kanë deklaruar se e kanë njoftuar ambasadorin gjerman me problemet e mosnjohjes së diplomave shqiptarëve, si dhe për hapat që do të ndërmerren për tejkalimin e këtyre problemeve

Ambasadori i Gjermanisë në Beograd Volfram Mass gjate qëndrimin e tij në Luginë të Preshevës ka takuar udhëheqësit institucional shqiptarë me prefektët e Preshevës dhe të Bujanocit, Nadër Sadikun e Shaip Kmaberin, si dhe deputetin e vetëm shqiptar në Parlamentin serb, Riza Halimin, me ç'rast ka biseduar për problemet me të cilët ballafaqohen shqiptarët e këtij rajoni. Temë qendrore e këtyre takimeve ka qenë problemet e shqiptarëve, veçmas çështja e mosnjohjes së diplomave të shqiptarëve, të cilat janë me vull të UNMIK-ut, nga ana e pushtetit serbe, sikundër edhe problematika e mosintegritimit të tyre në Trupin Koordinues të Qeverisë serbe për këtë rajon.

Ambasadori gjerman Mass, ka shprehur gatishmëri që të ndihmojë që problemet të tejkalohen dhe ka thënë se Serbia jugore është një rajon i veçantë dhe se problemet e grumbulluar me vite të tëra janë duke u zgjidhur dhe se ky rajon ka nevojë për

ndihmë ekonomike dhe sociale. Ai po ashtu është shprehur për domosdoshmërinë e arsimit të rinjve shqiptarë me qëllim të integritimit të tyre në këtë shoqëri.

Ndërkaq, përfaqësuesit institucional

të shqiptarëve të Luginës kanë deklaruar se e kanë njoftuar ambasadorin gjerman me problemet e mosnjohjes së diplomave shqiptarëve, si dhe për hapat që do të ndërmerren për tejkalimin e këtyre problemeve. (RTK)

